



Në pajtim me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 64 dhe nenin 43 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-2015, për Shtetësinë e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 12.08.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nxjerr këtë:

VENDIM

Për të drejtën e votës së personave të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës

- I. Miratohet rekomandimi i Këshillit për Çështje Ligjore, lidhur me të drejtën e votës së personave të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës.
- II. Personat që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës, largohen nga Lista Votuese.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që, t'i njoftoj të gjithë personat për arsyet e largimit nga Lista e Votuesve.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsvetim

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i jep të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet çdo shtetasi të Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme të drejtën e votës, u njeh edhe qytetarëve jashtë Kosovës, me kushtin që para plotësohen kriteret ligjore. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias, sikurse edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës kushtëzon të drejtën e votimit me kushtin e të qenurit shtetas i shtetit përkatës.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe legjislacioni sekondar zgjedhor nuk saktësojnë asgjë lidhur me atë se, a kanë të drejtë votimi qytetarët që kanë humbur shtetësinë. Kjo zbrazëti në ligj, ka krijuar shpesh herë situata të paqarta lidhur me atë se a duhet edhe personat që kanë kërkuar lirim nga shtetësia e Kosovës, përkatësisht që e kanë humbur shtetësinë e Kosovës të votojnë në zgjedhjet në Kosovë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Shtetësinë sqarojnë me tutje çështjen e të drejtës së votimit në Kosovë dhe mënyrat kur një qytetar i Republikës së Kosovës e ka humbur shtetësinë Kosovës.

Lirimi nga Shtetësia me vendim të organit kompetent shtetërorë sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 04/L-2015, për Shtetësinë është një nga mënyrat kur një qytetar i Republikës së Kosovës e humb shtetësinë. Andaj, pasi të jetë verifikuar se ndonjë qytetari të Republikës së Kosovës me vendim i është aprovuar kërkesa nga organi kompetent shtetëror për lirim nga shtetësia, ai/ajo e ka humb automatikisht edhe të drejtën për të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur në kuptim

te neni 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që thotë: "Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet...".

Siç shihet, Kushtetuta është mjaft e qartë dhe e drejtpërdrejtë, kur e përdorur frazën "çdo shtetas" përmes së cilës përfshinë dhe ua njeh të drejtën e votimit vetëm shtetasve të Kosovës, pa lejuar hapësirë për ndonjë interpretim më të gjerë. Andaj, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Prishtinë, 12.08.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Kadonqi





Data	11.08.2021	Ref. Nr.
Për	Komsionin Qendror të Zgjedhjeve	
Nga	Këshilli për Çështje Ligjore	
Përmes	Burim Ahmetaj- Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së	
Lënda	Rekomandim lidhur me të drejtën e votës së personave të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës	

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i jep të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet çdo shtetasi të Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme të drejtën e votës u njeh edhe qytetarëve jashtë Kosovës, me kushtin që para plotësohen kriteret ligjore. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias, sikurse edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës kushtëzon të drejtën e votimit me kushtin e te qenurit shtetas i shtetit përkatës.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe legjislacioni sekondar zgjedhor qëndrojnë të heshtur lidhur me atë se a kanë të drejt votimi qytetarët që kanë humbur shtetësinë. Kjo zbrazëti në Ligj ka krijuar shpeshherë situata të paqarta lidhur me atë se a duhet edhe personat që kanë kërkuar lirim nga shtetësia e Kosovës, përkatësisht që e kanë humbur shtetësinë e Kosovës të votojnë në zgjedhjet në Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Shtetësinë sqarojnë me tutje çështjen e te drejtës se votimit në Kosove dhe mënyrat kur një qytetar i Republikës së Kosovës ka humbur shtetësinë Kosovës.

Lirimi nga Shtetësia me vendim të organit kompetent shtetërorë sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 04/L-2015, për Shtetësinë është një nga mënyrat kur një qytetar i Republikës së Kosovës humb shtetësinë. Andaj, pasi kjo të jetë verifikuar se ndonjë qytetari të Republikës së Kosovës me vendim i është aprovuar kërkesa nga organi kompetent shtetëror për lirim nga shtetësia, ai/a jo e ka humb automatikisht edhe të drejtën për të zgjedhe dhe për t'u zgjedhur në kuptim të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, [neni 45; *Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet...*]. Siç shihet, Kushtetuta është mjaft e qarte dhe e drejtpërdrejt duke përdorur frazën 'çdo shtetas' përmes se cilës përfshinë dhe ua njeh të drejtën e votimit vetëm shtetasve të Kosovës pa lejuar hapësirë për ndonjë interpretim me te gjere.

Për më tepër, në këtë kontekst, me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në rastet K145/20 dhe K146/20, në lidhje me interpretimin normave ligjore, është përcaktuar që normat ligjore nuk duhet të interpretohen in blanco, në mënyrë strikte, të ngurtë, tekstuale e të shkëputur nga normat tjera ligjore dhe nga fryma e Kushtetutës. Gjykata ka ritheksuar obligimin, mes tjerash, edhe të institucioneve publike që vendimmarrjen e tyre ta bazojnë jo vetëm në ligj por edhe në Kushtetutë (paragrafët 112-117).